



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

NJOFTIM

**PËR PRANIMET NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE "MASTER",
"MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER I SHKENCAVE"
PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019
NË
UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**

Ju njoftojmë se aplikimet në programet e ciklit të dytë "Master " "Master Profesional " dhe "Master iShkencave " me kohë të plotë në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, bëhen pranë sekretarive të njëjësive kryesore në periudhën ,

3 Shtator deri në 12 Tetor 2018

Programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë që ofrohen nga Universiteti "Eqrem Çabej" janë si më poshtë :

PROGRAME TË CIKLIT TË DYTË "MASTER"

1.	"Master " në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Matematikë – Fizikë
2.	"Master " në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Matematikë – Informatikë
3.	"Master" në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Biologji – Kimi
4.	"Master " në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek
5.	"Master " në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Gjuhë dhe Qytetërim Italian
6.	"Master " në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Gjuhë dhe Letërsi
7.	"Master " në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Gjuhë Angleze
8.	"Master" në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Histori Gjeografi

PROGRAME TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL”

1.	“Master Profesional” për Arsimin Fillor Kl I – V
2.	“Master Profesional” për mësues ndihmës në arsimin gjithëpërfshirës

PROGRAME TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL”

1.	“Master Profesional ” në Kontabilitet Financë
2.	“Master Profesional ” në Administrim Publik
3.	“Master Profesional” në Turizëm

PROGRAME TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE”

1.	“Master i Shkencave ” në Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Arkeologjike
2.	“Master i Shkencave ” në Gjuhësi
3.	“Master i Shkencave ” në Letërsi
4.	“Master i Shkencave ” në Biologji Mjedisi dhe Zhvillimi

Kandidatët paraqiten personalisht ose nëpërmjet një personi të autorizuar prej tij pranë sekretarisë mësimore dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Diplomë, ose fotokopje të saj të njehësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomë të ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës së njehësuar me origjinalin ose në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.
- b. Diplomën e maturës shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopjen të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatën që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 ” të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore DAR/ZA).

Në rast se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin duplikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtorja e shkollës së mesme ku kanë përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësi përkatese arsimore vendore DAR/ZA, ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave.

- c. Formulari i aplikimit (sipas formatit të shtojcës nr. 6, bashkëlidhur këtij Udhëzimi);
- d. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identitetit, letërnjoftim ose pasaportë);
- e. Dy fotografi
- f. Mandat pagesa e tarisë së regjistrimit në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër.

Për çdo informacion shtesë mund të vizitoni faqen online të univerësitetit www.uogj.edu.al dhe mund të kontaktoni në numrin e kontaktit 06840300043.

REKTORATI
I
UNIVERSITETIT “EQREM ÇABEJ” GJIROKASTËR